


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	12.06.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Agron Veseli Menaxher i Zyrës së Prokurimit në QKUSK
CC:	Prof.Ass.Dr. Fatmir Dragidella Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizimi me karrige stomatologjike unitëve për nevojat e QKUSK-së"



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me karrige stomatologjike unitëve për nevojat e QKSUK-së" me numër prokurimit 20670900-012-013-121 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra e Prokurimit t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

Zyra e prokurimit në QKUSK, si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Furnizim" të procedurës së hapur me nr. prokurimi 20670900-012-013-121 dhe titull tenderi "Furnizimi me karrige stomatologjike unitëve për nevojat e QKUSK" në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit të neni 9.1 i Dosjes së tenderit të Kërkesat mundësit teknike dhe /ose profesionale pika 3 dhe 4 Dokumentet e Kërkuara – ka kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë: Afatin e Liferimit (të ceket kohëzgjatja nga ana e O.E), Shërbimet pas shitjes dhe asistencë teknike e pajisjes së ofruar (Montimi dhe Mirëmbajtja).

Zyra e prokurimit në QKUSK, këto kërkesa i ka shpalosur edhe një herë duke i zbërthyer në kuadër të aneksit 6, kriteret për dhënie të kontratës pika 2 dhe 5 tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ku ka paraparë: Operimi dhe shërbimet pas shitjes dhe asistenca teknike e pajisjes së ofruar (Montimi dhe Mirëmbajtja) – pesha e këtij nën kriteri është 15 % të poentimit, Afati liferimit – pesha këtij nën kriteri është 15% poentimit.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- Dispozitën e nenit **52.4** të LPP-së **04/L-042**.

Me respekt!

